

RAPORTI TEKNIK I PROJEKTIT

NDERTIM E HIDROCENTRALIT HUMELICË

Investitori: Shoqeria "GJEOKONSULT & CO" SH.P.K.

Shoqeria "ENGINEERING SYSTEM" SH.P.K

Fuqia e instaluar: 1994 kW

Prodhimi vjetor i energjise elektrike: 7,102,066 kWh/vit

**Pozicioni i zgjedhur: Rrjedha e përroit të Gurrës me
grykëderdhje ne lumin Drinos**

**Adresa: Fshati Humelicë, Njësia Administrative Cepo,
Bashkia Gjirokastër**

Tiranë, 2020

a) qëllimin e projektit të propozuar;

Qëllimi themelor i projektit të propozuar është prodhimi i pastër i energjisë elektrike duke realizuar një vlerësim të përgjithshëm të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore të projektit me synim parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis. Realizimi i ndërtimit të hidrocentralit, përveç qëllimit kryesor të prodhimit të energjisë elektrike, do të ndikojë pozitivisht dhe në përmirësimin e kushteve social-ekonomike të komunitetit të zonës. Zhvillimi i këtij aktiviteti bazohet në studimet e hershme dhe të reja të shfrytëzimit të rjetit hidrologjik të pjesëve të përroit të Gurrë që derdhet në lumen Drinos. Shoqëria investitore ka angazhuar grup specialistësh përkatësisht të gjeologjisë, hidrogeologjisë, topografisë, inxhinier mjedisi, në të gjithë pellgun ujëmbajtës të luginës, veçanërisht në pjesët ku do të ndërtohet HEC Humelice. Ky aktivitet si pasoje e zhvillimit të projektit, qëllimit dhe ndërhyrjes në mjedis klasifikohet si: ndërtimi i hidrocentraleve të vegjël lumorë.

b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;

Projektit për ndërtimin e HEC-it "HUMELICË", shfrytëzon ujrat e përroit të Gurrës, me vendodhje pranë Fshatit Humelicë, Njësia Administrative Cepo, Rrethi Gjirokastrës


Skema e shfrytëzimit hidroenergjitik të HEC-it ka përcaktuar kuotën e sipërme dhe të poshtme të veprave si më poshtë:

- Vepra e Marrjes ▼ 262.00 m (përroi Gurrës) (X=504710.271 Y=4447418.247)
- Aksi Turbinave ▼ 172.00 m (X=506674.702; Y=4448731.471)

Më poshtë në tabelen nr.1 po japim edhe koordinatat e të gjitha veprave hidroteknike që parashikohen të ndërtohen për këtë HEC:

Tab.1: KOORDINATAT E VEPRAVE sipas sistemit KRGJSH			
VEPRAT HIDROTEKNIKE	KOORDINATA X	KOORDINATA Y	KOORDINATA Z
VEPRAMARRJES (përroi Gurrës)	504710.271	4447418.247	262.00
GODINA HEC-i "HUMELICË"	506674.702	4448731.471	172.00

**SKEMA SE SHFRYTEZIMIN HIDROENERGJETIK E HEC-it "HUMELICE",
NE PERROIN E GURRES, GJROKASTER
SH 1:25.000**



KOORDINATAT E GJOKINES
X = 50874.702
Y = 4448731.471
Z = 172.00 m mnd

GJOKINA E
HEC-it "HUMELICE"
NE KUOTEN 172.00 ebs

TUBACIONI RENIES NE PRESION
ME GJATESI 100m L=100m
L=1700m ϕ 400mm
L= 50m ϕ 1200mm


NEPRA E MARRRES
NE KUOTEN 252.00 ebs
KOORDINATAT E VA
X = 58410.271
Y = 4448731.471
Z = 252.00 m mnd

UNA ELEKTRORE TRAJI PRA LOKONALE
HEC-it DERTI TRAJI GJROKASTRES
ME GJATESI 100m L=100m

Sip. = 27.10 km²



Pamje të zonës ku do të ndërtohet vepra e marrjes së HEC-it



Pamje të zonës ku do të kalojë derivacioni i HEC-it

Sipërfaqja e Zonës që do të përdoret për Zhvillimin e projektit aktualisht sot është e lirë nga objektet e tjera. Te vepra e marrjes dhe nenobjektet e tjera të HEC-it nuk kemi zhvillime të objekteve të tjera dhe ndërtimi i tyre realizon marrjen dhe përdorimin e ujit duke mos ndikuar në ndryshime të theksuara të shtartit të perroit dhe territit ku ndërtohen nenobjektet e tjera.



Pamje te zones ku do te ndertohet baseni I presionit te HEC-it



Pamje të zonës ku do të ndërtohet Godina e HEC-it



Pamje e derdhjes së përroit në lumin Drinos poshtë godinës së HEC-it

c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e Gjirokastrës kufizohet në veri me bashkinë Tepelenë, në lindje me Bashkinë Libohovë, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkitë Himarë dhe Delvinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Gjirokastrës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 25.301 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil ajo numëron 52.054 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 469.25 km². me një densitet prej 53.91 banorë/km² sipas Censurit 2011 dhe 110.93 banorë sipas Regjistrimit Civil.

Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Gjirokastra, Cepo, Lazarat, Picar, Lunxhëri, Odrie dhe Antigone. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Gjirokastër dhe e qarkut Gjirokastër. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 38 fshatra.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Censur 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Gjirokastër	Qyteti Gjirokastër	Gjirokastër	Qyteti Gjirokastër	25,301	52,054	469.25
		Cepo	Fshatrat; Fushëbardhë, Zhulat, Taroninë, Mashkullorë, Palokastër, Çepun, Kodër, Plesat, Kardhiq, Prongji, Humelicë			
		Lazarat	Fshatrat; Lazarat, Kordhoce			
		Picar	Fshatrat; Picar, Shtëpëz, Kolonjë, Golem, Kaparjel			
		Lunxhëri	Fshatrat; Qesorat, Dhoksat, Këllëz, Mingul, Nokovë, Erind, Gjat, Kakoz, Karjan, Valare			
		Odrie	Fshatrat; Andon Poçi, Hundëkuq, Tërëbuq, Labovë e Madhe, Labovë e Vogël			
		Antigonë	Fshatrat; Asim Zeneli, Arshi Lengo, Krinë, Tranoshisht, Saraqinisht			

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Gjirokastrës do të përbëhet nga qyteti i Gjirokastrës, i cili prej vitit 2005 ndodhet në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si dhe zonat rurale kodrinore përreth, të përqendruara më së shumti te prodhimet blegtorale.



Gjirokastra është një qytet tregtar i stilit otoman, ndër të paktët të tillë të mbijetuar në Ballkan. Qyteti ka mbi 800 ndërtesa historike, shumë prej të cilave rrezikohen nga degradimi. Katet përdhese të shtëpive karakteristike shërbenin si struktura mbrojtëse edhe depo të shtëpive. Ndërsa katet e

sipërme shprehnin mikpritjen gjirokastrite, kulturën dhe mënyrën e jetesës së tyre.

Kostumet lokale të Gjirokastrës janë tradicionalisht të zbukuruar me qëndisma të komplikuar. Po ashtu prodhohen në mënyrë artizanale qilima e velenxa, triko, çorape e doreza. Të famshme në të gjithë vendin janë dantellat e Gjirokastrës; punime me grep dhe qëndisimat. Ndërsa burrat përpunojnë drurin dhe gurin. Veshjet tradicionale popullore të grave zbukuroheshin me fije metalesh të çmuara si kostumet e famshme të grave të Lunxhërisë. Muzika tradicionale polifonike shqiptare ka stilin e saj në Gjirokastrë me interpretime virtuozë të disa gjeneratave, përfshirë sot edhe një grup fëmijësh. E integruar në Iso-polifoninë shqiptare, ajo është njohur më 2005 nga UNESCO si *"trashëgimi kulturore e paprekshme"*.

Pjesë e bashkisë së re do të jetë edhe Parku Arkeologjik i Antigonesë-Adrianapol, i cili u krijua në vitin 2005 me një sipërfaqe prej 92 hektarësh.

Burimet kryesore të ekonomisë urbane në Gjirokastrë janë turizmi dhe manifaktura me material porositës, e cila shërben përgjithësisht për tregun grek dhe që gjatë viteve të fundit është goditur rëndë për shkak të krizës në Greqi.

Gjirokastra është gjithashtu qytet me aktivitet të konsiderueshëm tregtar, veçanërisht sa i përket importeve nga Greqia.

Zona rurale që i bashkëngjitet qytetit është e njohur për blegtorinë e imtë dhe për produktet blegtorale shumë cilësore.

Gjirokastra është zona më e prekur në Shqipëri nga emigrimi masiv i popullsisë përgjatë dy dekadave të fundit, gjë që ka sjellë edhe plakjen e shpejtë të popullsisë. Sipas regjistrimit të popullsisë 2011, qarku i Gjirokastrës ka moshën mesatare më të lartë në Shqipëri me gati 40 vjeç.

Sfidat me të cilat do të përballët pushteti vendor pas ndarjes së re

Turizmi në qytetin e Gjirokastrës ka shënuar një hov cilësor gjatë viteve të fundit. Megjithatë, përballë bashkisë së re shtrohet nevoja e përmirësimit të kapaciteteve për promovimin dhe administrimin e turizmit si dhe për zgjatjen e sezonit turistik përtej muajve të pranverës dhe vjeshtës.

Qyteti numëron rreth 50-60 mijë vizitorë të huaj në vit si dhe zotëron një rrjet hotelesh që e përballojnë këtë fluks. Bashkia ka një zyrë informimi turistik, por pak produkte promovionale.

Zhvillimi i mëtejshëm i artizanatit, i produkteve tradicionale ushqimore dhe i gastronomisë konsiderohet një çështje që kërkon vëmendjen e vazhdueshme të autoriteteve vendore.

Me financime të Bashkisë apo me mbështetjen e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, në Gjirokastrë po realizohen disa ndërhyrje të rëndësishme në përmirësimin e infrastrukturës si: rikonstrukcioni i Parkut të Viroit, projekti për rrugën hyrëse nga krahu verior (përfshi një korsi për biçikleta dhe këmbësorët) apo shtrimi i rrugëve me kalldrëm në qendrën historike.

Megjithatë, Bashkia e re do të duhet të zgjidhë problemin e betonizimit në lagjen 18 Shtatori dhe mungesën e infrastrukturës arsimore në këtë lagje, ku ekziston vetëm një shkollë e mbingarkuar me nxënës.

Transporti i nxënësve në të gjitha shkollat e bashkisë së re konsiderohet një tjetër çështje që kërkon zgjidhje, pasi depopullimi i shumë zonave ka sjellë mbylljen e shkollave në fshatrave dhe rritjen e distancave për fëmijët.

Furnizimi me ujë të pijshëm pritet ndërkohë të zgjidhet përfundimisht pas përfundimit të rikonstruktimit të ujësjellësit, i cili përfshin gjenerimin e rjetit të vjetër si dhe ndërtim deposh të reja.


Bashkia pritet të prokurojë një financim për zgjerimin e korsisë rrugore nga Rruga kombëtare në hyrjen jugore në sheshin kryesor të Qendrës Historike. Parashikohet ngritja e një parkingu dhe mobilime të tjera urbane, të cilat synojnë kthimin e zonës së Pazarit të vjetër në një zonë këmbësorësh gjatë sezonit turistik Maj –Tetor.

d) *skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit*

Skema e shfrytëzimit hidroenergjitik për HEC HUMELICË është një nga elementët më të rëndësishëm të projektit të këtij HEC-i, i parashikuar të ndërtohet në Zonën e Fshatit Humelicë, Rrethi i Gjirokastrës.

Studimi i projektit të Zbatimit të HEC HUMELICË është bërë:

- Nga kuota 262.00m VM deri në kuotën 172.00m abs Aksi i Turbinave;
 Varianti i pranuar për HEC-in "HUMELICË" me derivacion me tubacion është varianti me optimal për një shfrytëzim maksimal të shfrytëzimit energjitik të një lumi apo përroi. Skema e paraqitur diktohet nga kushtet topografike, gjeologjike, hidro-gjeologjike, sociale dhe mbi të gjitha ekonomike.



HEC-in "HUMELICË, Shfrytëzon ujrën e përroit të Gurrës i cili merret me anë të një veprë marje (VM) të tipit malor ansor në kuotën 262.00m m.n.d.

Uji nga vepra e marrjes VM dhe baseni i presionit do të derivohet me anë të një tubacioni me gjatësi totale $L_{tot}=2990m$ dhe diametër ekonomik $\varnothing 1400mm$ deri në godinën e centralit.

Tubacioni është përzgjedhur të jetë GRP dhe kalon kryesisht në struktura të forta dhe të qëndrueshëm në kurrizin e kodrës. Në bazë të orografisë së terrenit dhe llogaritjeve hidroenergjitike është përzgjedhur që tubacioni të ndahet në tre segmente me diametra të ndryshëm në mënyrë që të zvogëlojmë humbjet në tubacion dhe të reduktohen kostot:

- L1a=1370ml me diametër të brendshëm - 1500mm,
- L1b=1070ml me diametër të brendshëm - 1400mm dhe
- L1c= 550ml me diametër të brendshëm - 1200mm.

Segmenti i parë është parashikuar të ketë një pjerrësi rrelativisht të vogël, $i=0.0021$ pra 2.1përm, segmenti i dytë ka një pjerrësi $i=0.0037$ pra 3.7përm, ndërsa segmenti i tretë është parashikuar të jetë me presion $i=0.14$.

Gjithashtu duhet të theksojmë se segmenti i parë i tubacionit kalon nëpër kurrizet e kodrave, dhe për të eliminuar të gjitha problemet civile dhe ambientale si dhe për të mos patur humbje hidraulike në tubacion është parashikuar që tubacioni të kalojë edhe nëpër tre galeri të vogla të cilat do të kenë të dhënat si më poshtë:

- La= 90ml me përmasa BxH==250x300cm dhe pjerrësi $i=0.0021$.
- Lb=260ml me përmasa BxH==250x300cm dhe pjerrësi $i=0.0021$ dhe
- Lc= 90ml me përmasa BxH==250x300cm dhe pjerrësi $i=0.0021$.

Në fund të tubacionit të rënies me presion kemi godinën e hidrocentralit të HEC-it dhe turbinat në kuotën 172.00m m.n.d.

Godina do të pozicionohet në një hapësirë midis autostradës dhe rrugës së vjetër të Gjirokastrës. Pra sheshi i ndërtimit ka rrugë hyrëse, kështu që nuk do jetë e nevojshme hapja e rrugëve të tjera. Pranë godinës së centralit është parashikuar një hapësirë truall për të manovruar dhe parkuar mjetet e lëvizëshme (kamiona, vetura, etj) dhe ndërtimi i një parku të tillë nuk duhet të pengohet nga mungesa e hapësirës për vendosjen e paisjeve, të materialeve të ndërtimit etj.

Nga llogaritjet hidraulike të dhëna, bazuar në kurbën e qëndrueshmërisë me atë 73 ditore për Veprën e Marrjes është pranuar prurja llogaritëse $Q_{llg}=2.810m^3/sec$.

- Për një shfrytëzim maksimal në mënyrë optimale, një rëndësi të vecantë merr edhe përcaktimi i tipit dhe numrit të turbinave me prurjet dhe parametratsintetikë. Duke u mbështetur në literaturën bashkohore mbi tipet e hidroturbinave perëndimore, është paraparë mundësia e përcaktimit të numrit të turbinave në 2, një turbinë FRANCIS dhe një turbinë Pelton.
- 1 FRANCIS me prurje $Q_{llg1}=2.150m^3/sec$. Fuqi $P1=1536kW$ dhe energji $E1=5,468,591kWh$
- 1 PELTON me prurje $Q_{llg2}=0.660m^3/sec$. Fuqi $P2= 458kW$ dhe energji $E2=1,633,475kWh$

Tab.2: Tabela e të dhënave të turbines të Hec-it "HUMELICË"

Emertimi	Reniet Bruto (m)	Reniet Neto (m)	Qlllog (m3/s)	Fuqia llogaritur N (kW)	Energjia e prodhuar (kWh)	Tipi i Turbines	ORE PUNE (ore)
HEC-i "HUMELICË"	86.00	84.64	2.932	1994	7,102,066	1 Francis 1 Pelton	4246

PERFUNDIMISHT: Pra për Hec-in "HUMELICË" kemi një fuqi të instaluar totale prej P_{ins}=1994kw me një prodhim të energjisë vjetore për vitin mesatar me 50% siguri, prej E_{totale}=7,102,066 Kwh, (shih tabelën përmbledhëse më poshtë)

TREGUESIT KRYESORË HIDROENERGJITIKE TË HEC-it "HUMELICË"																		
MBI PËRROIN E GURRËS DEGË E LUMIT DRINOS, GJIROKASTËR:																		
EMERTIM I HEC-it	Sip. Pelligut (km ²)	Q _{mesatare} [m ³ /sek]	Q _{turbinave} [m ³ /sek]	Q _{ekologjike} [m ³ /sek]	K _{veprës} Marrjes [m]	K _{basenit} Presionit [m]	L Tubacionit [m]	Φ ekonomike tubacionit [m]	K _{Aksit} Turbinave [m]	H _{bruto} [m]	H _t (Humbjet tubacion) [m]	H _{neto} [m]	η [%]	Fuqia e llogaritur P _{ins} [kW]	Energjia e llogaritur E _{ins} [kWh]	Energjia reale E _{reale} [kWh]	ORE PUNE	
HEC-I HUMELICË	27.1	1.490	2.810	0.014	262.00	262.00	2990	1.4	172.00	90.0	5.87	84.13	0.86	1994	7,358,704	7,102,066	3690	
FUQIA E PERGJITHESHME E LLOGARITUR [kW]:														1994				
ENERGJIA VJETORE E PARASHIKUAR TE PRODHOHET [kWh]:															7,358,704	7,102,066		

Vepra e marrjes

Hydrocentrali që është parashikuar të ndërtohet është me një vepër marrje të tipit malor. Në përgjithësi tek përrrenjtë malorë rrjedhja karakterizohet me luhajtje të theksuara të prurjes në vlerë dhe në kohë si dhe me përmbajtje të lëndës së ngurtë fundore dhe pezull që ndyshon në sasi dhe në përbërje granulometrike. Nga pikëpamja granulometrike madhësia e lëndës së ngurtë ndryshon nga përmasat e gurëve të mëdhenj deri në grimca shumë të vogla dhe koloidale. te tillë janë edhe përrrenjte gjatë gjithë gjatësisë së tij nga burimet deri në derdhje në lumin Drinos. Në kushte të tilla vepra marrje më të përshtatëshme do të ishin ato me zgarë e tipit Tiroleze.



Foto nga vepra e marrjes VM-1, në përroin e Gurrës

Tubacionet e Rënies Së Ujit Në Turbina (Penstocks)

Tubacioni i rënies së turbinave për HEC-in është parashikuar GRP. Përmasimi i tij është kryer mbi bazën e llogaritjeve hidraulike, bazuar në prurjen llogaritëse të turbinave dhe rënien neto të tyre.



Pamje nga segmenti i dytë dhe i tretë ku do të kalojë tubacioni i rënies


Në përcaktimin e diametrit të tubacioneve është patur në konsideratë që humbjet hidraulike në sistemin e tubacionit të rënies të mos kalojnë vlera 4% deri 6% e rekomanduar edhe nga literatura.


Paraprakisht është bërë një studim për diametrin ekonomik të Tubacionit të rënies: Të dhënat për analizën janë marrë si më poshtë:

- Koeficienti i Maningut 0.011
- Prurja llogaritëse që kalon në secilin tubacion: 2.810 m³/s
- Gjatësitë e tubacioneve të turbinave: 2990 m

Baseni i presionit

Ne përgjithësi pozicioni i basenit të presionit vendoset në fundin e vepres së derivacionit dhe realizon hyrjen në kushte të caktuara të prurjes në tubacionin e turbinës. Në rastin tonë ai vjen mbas derivacionit segmenti i fundit. Në rastet me të përgjithshme baseni i presionit përbëhet nga dy elemente kryesore: Paradhoma, e cila është pjesa rakorduese midis kanalit të derivacionit dhe pjesa marrëse ose lidhja me tubacionin e turbinave. Për zgjidhjen hidraulike dhe permashimin e elementeve të basenit të presionit, është e nevojshme të merren disa komponente në konsideratë: Hapja (rakordimi) i mureve të bëhet në mënyrë të tillë që të ketë një shpërndarje uniforme të prurjes dhe të minimizojë humbjet. Kalimi i prurjes nga seksioni i gjërë katerkëndesh (nga baseni), në seksionin rrethor (tubacioni i turbinave) të bëhet me një hyrje të qetë. Pajisja me mjete mbështetëse mekanike, përfshirë zgarrat dhe porta shërbimi. Drejtimi i vendosjes së zgarrës të bëhet i tillë që të kalojë prurjen uniformisht. Shtjellat, ndrydhjet duhet eliminohen.






Godina e Centralit.

Godinat e centraleve janë objektet ku instalohen paisjet dhe makineritë e HEC-it, të tilla si turbinat, gjeneratorët, transformatorët, panelet e ndryshme elektrike, çelat, etj. Në varësi të numrit të turbinave të parashikuar për tu instaluar, kapacitetit të tyre (lidhet me përmasat e bazamenteve të turbinave) dhe kushteve konkrete të terrenit është përcaktuar edhe sipërfaqja minimale e godinës së hidrocentralit, e cila jepet edhe në preventivin përkatës të HEC-it. Godina e hidrocentralit është një objekt polifunksional, pasi përveç sallës së makinerive do të ketë edhe një ambient për zyrë, njëje hidrosanitare dhe sallën e komandimi etj. Numri maksimal i kateve do të jetë 1 kat. Lartësia e katit është rreth 9m lartë.

Godina e HEC-it Humelicë është parashikuar të ndërtohet në kuotën 172.00m mnd, ajo do të pozicionohet në hapsirën që krijohet ndërmjet autostradës dhe rrugës së vjetër Tepelenë- Gjirokastrë, kështuqë ajo është automatikisht e mbrojtur përse i përket të plotave të lumit nga autostrada. Gjithashtu theksojmë që niveli i ujit të lumit Drinos në pikën e derdhjes së përroit dhe shkarkimit të ujrave që do të dalin nga turbina është në kuotën 164.5m mnd.


Pozicioni i sheshit të ndërtimit të godinës është në afërsi të autostradës dhe është e kufizuar nga veriu dhe lindja me autostradën Tepelenë-Gjirokastrë, nga jugu dhe perëndimi është e kufizuar nga rruga dytësore e fshatit Picar. Hyrja për në sheshin e ndërtimit do të bëhet direkt nga rruga dytësore, kështu që nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja për në objekt.

Pranë godinës së centralit të HEC-it është parashikuar të pozicionohet edhe godina e HEC-it Kastrioti 1. Kështu që pranë tyre është parashikuar një hapësirë trualli për të manovruar dhe parkuar mjetet e lëvizëshme (kamiona, vetura, etj) dhe ndërtimi i një parku të tillë nuk duhet të pengohet nga mungesa e hapësirës për vendosjen e paisjeve, të materialeve të ndërtimit etj.




Pamje të zonës ku do të ndërtohet Godina e HEC-it "HUMELICË"


PLANSISTEMIMI I NDËRTESESË SË HIDROCENTRALIT TË HEC-it "HUMELICË", GJIROKASTËR:
SH 1 : 150



PLANVENDOSJA E NDËRTESES SË HIDROCENTRALIT TË HEC-IT "HUMELICË", GJIROKASTËR:



**PRERJA E TUNELIT TE DERIVACIONIT $L_{a+b+c}=440\text{m}$, TE HEC-IT "HUMELICË"
SH_ 1:20 A3**



GERMIME ME MINA SEKS. DETYRUAR
 VOL₁ = 13.62m²*440m = 5992.8m³
 BETONE b/a M250
 VOL₁ = 3.03m²*440m = 1333.2m³
 HEKUR PER BETONE
 Q = 8.16mm = 53.33Ton

S₁

e) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

Përgatitja e formacioneve përfshin këto punë:

- Njohja dhe saktësimi i rrjeteve të instalimeve nën tokë si p.sh.: tuba të furnizimit të ujësjellësit, tuba të shkarkimit, kablllo elektrike e telefonie etj.
- Matja e terrenit dhe marrja e provave të dheut
- Heqja e dheut me humus dhe transportimi apo ripërdorimi i tij.
- Hapja e gropave të themeleve deri në thellësinë e nevojshme

❖ **Përshkrimi i procesit ndërtimor për HEC Humelice**

Ndërtimi i nenobjekteve të HEC Humelice do të fillojë me hapjen e traseve të derivacionit duke shfrytëzuar rrugët ndihmëse të zonave të cilat janë egzistuese; Hapja e traseve do të bëhet e tillë që të shfrytëzohet për të shkuar të veprat e marrjes të cilat do të ndërtohen në shtratin e perrenjve me beton-arme, dhe në kthim do të ndërtohen derivacionet dhe tubacionet e sifoneve, dhe tubacionit të presionit që lidhë basenin e presionit me Godinen e centralit.

❖ **Lendet e para që do të përdoren për ndërtim.**

Për ndërtimin e objektit do të përdoren materialet si: Beton, hekur, tuba HDPE, çelik tulla, konstruksione metalik, tulla për ndërtimin e ambjentëve të shërbimit, dhe material të tjera të rifinaturës, si alumin xham, llaç etj. të cilat do të sigurohen pjesërisht me materialin e gurit që del nga gërmimet dhe një pjesë e inerteve do të merren në pikat me të afërta me zonën ku do të ndërtohet Hec-i. Karburanti do të furnizohet nga subjekte të licencuara për import, ruajtje dhe tregtim të karburanteve në republikën e Shqipërisë. Ndërsa për mbrojtjen nga pluhuri, për nevojën vetiake, mbrojtjen nga zjarri dhe shërbime të tjera do të përdoret ujë. Uji që do të përdoret për përgatitjen e betonit dhe përdorimet e tjera është i bollshëm dhe gjendet në afërsi të nenobjekteve për pije do të sigurohet nga burimet ku sigurohet dhe nga banoret e fshatrave ku do të zhvillohet projekti. Ndërtimet e objekteve të shërbimit do të bëhen me materialet e lehta sanduici që do të merren të gatëshme nga subjekte të specializuara. Sasia 3 kontoniere.

❖ **Përcaktimi i kapacitetit prodhues.**

Për një shfrytëzim maksimal në mënyrë optimale, një rëndësi të vecantë merr edhe përcaktimi i tipit dhe numrit të turbinave me prurjet dhe parametrat sintetikë. Duke u mbështetur në literaturën bashkohore mbi tipet e hidroturbinave përfundimtare, është paraparë mundësia e përcaktimit të numrit të turbinave në 2, një turbinë FRANCIS dhe një turbinë Pelton.

- 1 FRANCIS me prurje Qllg1=2.150m3/sek. Fuqi P1=1536kW dhe energji E1=5,468,591kWh
- 1 PELTON me prurje Qllg2=0.660m3/sek. Fuqi P2= 458kW dhe energji E2=1,633,475kWh.

Parametrat e HEC Humelice			
1	<i>Prurja llogaritese</i>	<i>m3/sek</i>	<i>2.810</i>
2	<i>Renja neto</i>	<i>m</i>	<i>84.13</i>
3	<i>Fuqia e Instaluar</i>	<i>kW</i>	<i>1994</i>
4	<i>Energjia (Viti i mestsr ,50%)</i>	<i>kwh/vit</i>	<i>7,102,066.0</i>

❖ **Produkti perfundimtar i prodhuar.**

Produkti perfundimtar eshte prodhimi i energjise elektrike duke shfrytezuar potencialin hidroenergjtik te ujit.

- f) *informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;*

Ky HEC do të kenë një fuqi të instaluar totale P=1994 kW. Energjia e prodhuar nga secila turbinë e HEC-it do të transmetohet me linje 20 kV me gjatësi 10500m deri tek pika e lidhjes me N/Stacionin e Gjirokastrës.

Linja është konstruktuar me 52 shtylla metalike me lartësi 18 m. Në majat e shtyllave do të vendoset trosi i cili do të shërbejë për mbrojtjen e linjës nga shkarkimet atmosferike.

Tensioni i daljes nga secila prej turbinave do të jetë 6,3 KV dhe nëpërmjet paneleve të fuqisë së tensionit të ulët do të realizohet mbrojtja e gjeneratorit,nga avari të mundëshme. Nga panelet e fuqisë energjia do të futet në transformatorin rritës, prej ku do të rritet niveli i tensionit deri në vlerën e tensionit 20 KV për Linjat e HEC-it deri tek pika e lidhjes, për transmetim për tu lidhur me sistemin. Dalja e transformatorit nëpërmjet çelës hyrese do të lidhet në zbarat e përbashkëta ku janë të lidhura edhe çelat e matjes për nevojat e kontroll-monitorimit të vetë HEC-it. Nga çelat e daljes nëpërmjet një kabulli XLPE do të lidhet me linjen ajerore të shtyllëzimit.

Zona furnizohet me energji elektrike pa nderprerje, por prerjet sporadike te energjise e kane prekur dhe ate rralle here e kryesisht gjate dimrit si pasoje e difekteve nga ngricat. Megjithate, jane bere perpjekje per te permiresuar infrastrukturen e energjise elektrike ne kete drejtim. **Ndertimi i Hec-ve rrit kapacitetin prodhues te energjise elektrike dhe i vjen me afer kerkesave te banoreve prane tij.**

Infrastruktura e projektuar dhe ajo egzistuese per ndertimin e HEC HUMELICË, dhe linja e energjise elektrike per lidhjen me nenstacionin jane projektuar ne perputhje me kushtet klimaitike dhe mjedisore te zones.

Infrastruktura e projektuar dhe ajo egzistuese per ndertimin e HEC HUMELICË dhe linja e energjise elektrike per lidhjen me nenstacionin jane projektuar ne perputhje me kushtet klimaitike dhe mjedisore te zones.


- Te gjitha ndertesat apo strukturat e vendosura ne lartesi duhet te pajisen me rufepritesa statike ne menyre qe te presin rrufete e rena ne kohe shtrengatash.
- Mbrojtja mekanike ne varesi nga instalimet dhe aplikimet e paisjeve elektrike, mbrojtja sipas klasave behet sipas standartit IEC 60529.

Qellimi themelor I projektit eshte prodhimi i paster i energjise elektrike duke realizuar vleresim te pergjithshem te integruar dhe ne kohë të ndikimeve mjedisore të projektit me synim parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Ne kete menyre, do te shfrytezohen rezervat hidroenergjitike te lumit te Bushtrikes, por gjithnje duke ber te mundur qe nje minimum ujerash te percaktuar ne kete studim gjate gjithë periudhes se funksionimit te lihet te rrjedhe ne shtratin natyror te lumit direkt nga vepra e marrjes per arsye ekologjike. Gjate punimeve, do te kete ndikime negative, te cilat do te jene te perkoheshme sepse do te jene te pranishme vetem gjate fazes se ndertimit te Hec-it. Gjate shfrytezimit te tyre, keto ndikime negative nuk do te ekzistojne me, nderkohe qe efektet pozitive nga projekti do te ndihen gjate gjithë kohes ne vijim.

❖ **Furnizimin me ujë.**

Ne pjesen me te madhe te nenobjekteve uji eshte shume afer pasi punohet ne afersi te fshatrave dhe eshte I mundur furnizimi me uje, ne ato nenobjekte ku uji eshte larg, furnizimi do te behet me depozite qe do te furnizohet me autobot qe ka ne perdorim subjekti.




❖ **Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve.**

Zhvillimi I aktivitetit do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis gjate ndertimit te objektit, burime te tjera ndotese per ajrin nuk do te kete. Pajisjet qe do te perdoren per shfrytezimin dhe transportin e materialeve dhe te dheut do te jene bashkohore dhe ne gjendje te mire teknike ne menyre qe te shmangen emetimet nga djegia e lendeve djegese qe ato perdorin.

Ne vende te caktuara ne projekt (shesh-depozitimi) parashikohet depozitimi I materialit te nga germimet dhe perpunimi i tij me toke vegjetale per te mundesuar mbjelljen e bimeve dhe pemeve karakteristike te zones gjate fazes se rehabilitimit. Dherat e depozituara ne damba do te perpunohen me dhera te pasura me humuse, do te transportohen dhe shperndahen ne sheshin e shkalleve te skarpave dhe shesh-depozitimit me trashesi mbi 20cm dhe do te pyllzohen me bime qe rriten ne zone per gjelberimin e saj.

Zona nuk ka fasilite te trajtimit te ujerave re zeza apo heqjes se mbeturinave te ngurta. Ujerat e zeza te fshatrave qe ndodhen kryesisht ne taracat lumore te degëzimeve te perrenjeve dhe i derdhen ato ne keto perrenj, gje e cila bie ndesh me parametrat e cilesise se ujerave te embel dhe per trajtimin e ujerave me qellim ruajtjen e tokes dhe ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga ndotja, gjate ndertimit te hec-ve do te ndertohen gropa septike per trajtimin e ujrave ne godinen e Hec-it.



Në kohën e ndërtimit të rrjetit të jashtëm të kanalizimit, ujërat e zeza të dala nga objekte të veçuara apo zona të tëra të qendrave të banuara (në rastin tone të godinës së centralit) mund të mblidhen në gropa septike (të zeza), nga të cilat, në kohë të caktuara largohen me mjete të ndryshme transporti (autobote etj) të autoritetit përkatës Ujësjellës Kanalizime sh.a.

Në këto gropa lëndët organike që përmbajnë ujërat e zeza kanë aftësi të dekantojnë lehtë meqë shpejtësia e rrjedhjes së këtyre ujrave prodhon gaze me erë të rëndë dhe zvogëlon vëllimin e tij. Kështu një gropë septike përfaqëson një farë dekantuesi të mbyllur, tek i cili bëhet dekantimi i ujrave të zeza dhe kalbëzimi i llumit të dekantuar. Gropat septike mund të kenë një, dy ose tri ndarje nëpër të cilat ujërat e zeza kalojnë nga e para në të dytën e kështu me radhë. Në seksionin e parë, dekantimi është më i madh, prandaj edhe përmasat e tij merren më të mëdha se të seksioneve të tjera. Llumi, sidomos në të ndarën e parë, ngjeshet mirë dhe zvogëlon vëllimin 3-4 herë. Lëndët në gjendje pezull notojnë në sipërfaqe dhe aty duke u tharë e duke u ngjeshur formojnë një farë cipe. Në mënyrë që ujërat e zeza të hyjnë normalisht në gropë e të dalin prej saj pa u penguar nga kjo cipë e krijuar, tubat e hyrjes dhe të daljes, si dhe vrimat ndërmjet ndarjeve të gropës pajisen me tridegësh (pjesë T). Vrimat e lëna në muret ndarëse kanë përmasa (15x15) cm.

Gropat septike ndërtohen me tulla, gurë, me beton monolit ose me element të parapërgatitur prej betoni.

Për të mënjeluar daljen e gazeve e të erës së keqe, gropat septike, nga sipër soletës mbulohen me argjilë të përzier me zhavorr ose me skorje me një trashësi që luhetet midis 0.5 dhe 0.8m. Në disa raste, kur pozicioni i gropës septike nuk prish ambientin higjieno-sanitar të truallit, gropat septike ndërtohen të filtrueshme, megjithatë në rastin e godinës së centralit ky rast nuk duhet zgjedhur në mënyrë kategorike, sepse godina do të pozicionohet pranë shtratit të përroit çka do të sillte ndotje të tij.

Këto gropa që mund të kenë formë të rrumbullakët ose drejtkëndëshe ndërtohen siç u përshkruan më lart, me gurë, me tulla, me beton ose butobeton. Në fund të gropës shtrohen disa shtresa me zhavorr me madhësi të kokrrizave 1 deri në 10 cm. Pjesa e poshtme e mureve të gropës mund të ndërtohet me vrima ose muratura mund të ndërtohet pa llaç në mënyrë që të dalin ujërat e filtruara.

❖ **Informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja.**

Ne zonen e ndertimit ka shume egzistuese dhe qe ne shume nenobjekte shkojne deri te sheshi i ndertimit te tyre.

E gjithë lugina e përroit deri në afërsi të qendrës së banuar Humelicë është i lidhur me rrugë dytësore të Picarit me autostradën Tiranë-Gjirokastër që përshkon gjithë luginën e Drinos.

- Gjate fazes se ndertimit do te shfrytezohen rruget egzistuese duke I rehabilituar ato me ndikime minimale ne aspektin mjedisor.
- Gjate fazes se shfrytezimit qarkullimi i automjeteve do te jete i kufizuar dhe nuk do te perbeje rrezik sinjifikativ per aksidente. Korridore te hyrje-daljeve ne veper dhe rruget komunikuese te objekteve behen ne vende të pershtashme e pa prishur breza pyjor te bregperroit. Rruget te reja qe do te hapen nga shoqeria investitore nuk ka, por do te rehabilitohet ajo egzistuese e cila sherbente per fshatin si rruge sherbimi per te bregu i lumit. Kjo rruge me pas do te mirembahet ne nevoje te vepres dhe te komunitetit te zones.

Persa i perket energjise elektrike per kantierin e ndertimit lidhja do te behet ngarrjeti kryesor i zones icili eshte ne afersi dhe ne rastin e ndertimit te tubacionit te presionit etj do te perdoren gjeneratore.

g) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit.

Gjatë punimeve të zbatimit të projektit do të kryhen punime betoni për veprën e marrjes, për shuarjen e energjisë në dalje, për ankera dhe blloqe mbështetës të tubacionit të rënies së turbinave, për ankera e blloqe mbështetës pranë sallës së turbinave me beton për mbrojtje nga përmbytjet.

Studimi parashikon realizimin e këtyre veprave me objektet dhe nënobjektet e tyre me një afat kohor brenda 24 muajsh, nga dita e dhënies së lejeve përkatëse nga autoritetet shtetërore. Normalisht punimet do të fillojnë me ato përgatitore si ngritja e kantierëve, sigurimi i rrugëve për në shesh ndërtim, punimet e ndërtimit, montimi i makinerive dhe pajisjeve, punimet elektrike, provat e kolaudimit dhe të lëshimit në punë të agregatëve.

HEC-i "HUMELICË"										
GRAFIKU I ZHVILLIMIT TË PUNIMEVE (+48 MUAJ)										
Nr.	OBJEKTI	Ditë	VITI I				VITI II			
			Tremujori I	Tremujori II	Tremujori III	Tremujori IV	Tremujori I	Tremujori II	Tremujori III	Tremujori IV
1	VEPRA E MARRJES VM I NË KUOTËN 262.00 m abs.	100	←→							
2	TUBACIONI I RËNIES SË TURBINAVE Ø1400mm, Ltot=2990 ml	270	←→							
3	SISTEMIM RRUQE EKZISTUESE PER NE OBJEKT, L=2000 m	90	←→							
4	NDERTESA E CENTRALIT NE KUOTEN 172m abs + KANALI I LARGIMIT	90					←→			
5	MAKINERI - HEC-I "HUMELICË"	90					←→			
6	PAISJE ELEKTRIKE	90					←→			
7	LINJA ELEKTRIKE 20KV - N/Stacioni Gjtrokastres	120					←→			
8	INSTALIME ELEKTRIKE	90					←→			
9	PROJEKTIM - MBIKQYRJE PUNIMESH - KOLAUDIM	720	←→							


Grafiku i zhvillimit të punimeve, HEC-i "HUMELICË"

h) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

Per ndertimin e nenobjekteve do te perdoret struktura beton/arme dhe gure, te cilat do te sigurohen pjeserisht me materialin e gurit qe del nga germimet dhe nje pjese e inerteve do te merren ne pikat me te aferta me zonen ku do te ndertohet Hec-i. Karburanti do te furnizohet nga subjekte te licencuara per import, ruajtje dhe tregtim te karburanteve ne republiken e Shqiperise. Ndersa per mbrojtjen nga pluhuri, per nevoja vetiake, punonjesit, mbrojtjen nga zjarri dhe sherbime te tjera do te perdoret uje. Uji qe do te perdoret per pregatitjen e betonit dhe perdorimet e tjera eshte i bollshem dhe gjendet ne afersi te nenobjekteve per pije do te sigurohet nga burimet ku sigurohet dhe nga banoret e fshatrave ku do te zhvillohet projekti. Ky aktivitet

eshte ndertimi i HEC Humelice, i cili konsiston ne prodhimin e energjise elektrike duke perdor ujin e perroit te Gurre. Uji perdoret jo vetem per prodhimin e energjise nepermjet hidroturbines por dhe rast pas rasti per lagjen e territorit ne menyre qe te mos kete krijim te pluhurave gjate veprimtarise se germimeve dhe transportit, sidomos ne kohe te thate dhe me ere, kjo sasi uji sigurohet permes depozitave te ujit qe shoqeria siguron per kete qellim. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pika te furnizimit me karburant. Ndertimet e objekteve te sherbimit do te behet me material te lehta sanduici qe do te merren te gateshme nga subjekte te specializuara. Sasia 3 konteniere.

SKICA E SHESHIT TE KANTJERIT




i) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit

Nuk ka lidhje te projektit te propozuar me projekte te tjera ekzistuese perreth. E vetmja lidhje eshte shfrytëzimi i perbashket i infrastruktures inxhinierike si lidhje me rrugen, lidhja me rrjetin e furnizimit me uje dhe energji elektrike.

Mbi vepren e marrjes se HEC Humelice, ne distancen rreth 40 m me lart vepres se marrjes, eshte shkarkimi i ujit te HEC Peshku Picar 1.

Ne skemen me poshte paraqitet situata dhe lidhje midis vepres se marrjes se HEC Humelice dhe Godines dhe shkarkimit te HEC Peshku Picar 1.

Shkarkimet e ujit te HEC Peshku picat 1 behen ne perroin e Gurre dhe perdoren nga HEC Humelice.



j) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret

Eshte perzgjedhur kjo zone sepse ndodhet ne afersi te rruges ekzistuese ka kushte te mira shfrytezimi te potencialit Energjistik te Perroit te Gurres, larg qendrave te banuara si dhe kapacitet te mjaftueshme dhe me interes ne prodhimin e energjise elektrike.

Theksojme per organet vendimmarrese, se mundesia e alternativave te marra ne konsideratë per perzgjedhjen e vendndodhjes se projektit nga subjektet ndertuese ne teresi jane ne nivele te kufizuara per keto arsye:

- Zona e ndertimit per shfrytezim te potencialit uJOR, percaktohet nga MIE me propozim te Subjektit dhe shqyrtimin e miratimit te AKBN pas plotesimit te nje sere kushtesh teknike dhe financiare nga Subjekti i interesuar per kete aktivitet.
- Investitori ka perzgjedhur kete zone per investim pasi eshte zone e lire nga pikpamja e shfrytezimit te potencialit uJOR dhe eshte e vetmja mundesi per

shfrytezim ne kete zone (duke shfrytezuar potencialin energjetik te Perroit te Gurre).

Përsa i përket studimit të rezervave teorike të një lumi apo përroi në aspektin praktik përcaktimi i tyre vlen vetëm për një krahasim, për të treguar shkallën e shfrytëzimit të rrjedhjes ujore në raport me përcaktimin real (faktik) sipas një skeme hidroenergjitike, përzgjedhja e të cilës varet nga shumë faktorë. Ndër faktorët më të rëndësishëm në përzgjedhjen e një skeme hidroenergjitike mund të përmëdim rrjetin hidrografik së bashku me pellgun shimbledhës, kushtet konkrete topografike të terrenit, treguesit gjeologo inxhinierike të zonës ku parashikohen objektet e ndryshme si dhe faktorët socialë e mjedisorë. Në të njëjtën kohë çdo skemë e përzgjedhur mbi bazat e faktorëve të mësipërm do të ketë edhe vetë koston ekonomike në se do tja vlente të investohej apo jo, objekt i të cilës është edhe studimi në fazën e projektit të Zbatimit të një HEC-i, apo i një sistemi HEC-esh në formë kaskade në shtratin e një përroi apo lumi.

Skema e shfrytëzimit hidroenergjitik për HEC HUMELICË është një nga elementët më të rëndësishëm të projektit të këtij HEC-i, i parashikuar të ndërtohet në Zonën e Fshatit Humelicë, Rrethi i Gjirokastrës. Nisur nga karakteristikat e vecanta që duhet të plotësojë projekti i zbatimit për HEC-et e vegjël, grupi i studimit është mbështetur në keto boshte kryesore:

- Në ndikimet sa me minimale dhe te menaxhueshme ne mjedisin e zones
- Në shfrytëzimin maksimal të potencialit të mundshëm hidroenergjitik të këtij HEC-i në basenin shimbledhës të përroit në studim, si pasuri kombëtare, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë skemës së shfrytëzimit hidroenergjitik të tij.
- Në gjetjen e zgjidhjeve teknike për shfrytëzimin e rënieve maksi male të tij.
- Në analizën e detajuar ekonomike financiare të investimit të propozuar dhe efektivitetit të tij.

k) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre

Uji perdoret jo vetem per prodhimin e energjise nepermjet turbinave por dhe rast pas rasti per lagjen e territorit ne menyre qe te mos kete krijim te pluhurave gjate diteve te nxehta dhe kur eshte e nevojshme, sidomos ne kohe te thate dhe me ere, kjo sasi uji sigurohet perms depozitave te ujit qe shoqeria siguron per kete qellim. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pika te furnizimit me karburant.

l) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj

Zbatimi i projektit nuk kerkon ndermarrjen e aktiviteteve te tjera shtese.

Ne fazen e ndertimit te Hidrocentralit nuk do te do te kete nevojte per ndertim te kampit pasi punetoret do te akomodohen ne fshatin me te afert, ku dhe do te jete dhe numeri me i madh i punetorve, per mbajtjen e materialve dhe organizimin e punimeve do te instalohen tre kontinier te cilet do te sigurohen te gatshme nga subjekte qe dispunojne te tilla.

m) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit

Mbeshtetur ne Ligjin Nr,107/2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", si dhe ne VKM Nr. 408, date 13.05.2015 "Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit", sipas nenit 9, pas perfundimit dhe miratimit te Procedures Paraprake te VNM-es, subjektit i hapet rruga per ndjekjen e procedures per marrjen e lejes se perdorimit te Ujit prane Agjencise se Menaxhimit te Burimeve Ujore dhe Agjencise se Basenit Vjose, dhe me pas Aplikimi per marrjen e lejes se ndertimit prane Agjencise se Zhvillimit te Territorit.

"GJEOKONSULT & CO" Sh.p.k.

Hamit MUSTAFA

ADMINISTRATOR

